

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË**, Divizioni penal, me gjyqtarin Lulzim Paçarizi, si dhe sekretarja juridike Behije Karaçica, në çështjen penale ndaj të akuzuarit M. B., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par 1 të KPRK-së, ndërsa sipas aktakuzës PP.nr.153/17 të dt.18.04.2017, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar publik, në prezencën e Prokurorit të shtetit Mone Syla të akuzuarit M. B. si dhe i dëmtuari H. B., gjykata me dt. 26.06.2018, merr këtë:

## A K T G J Y K I M

**I AKUZUARI: M. B.**, nga i ati R. dhe e ëma Gj. e lindur B., i lindur më ..., në fshatin Sh. komuna e Malishevës, ku edhe jeton, me nr.personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor privat, i gjendjes së dobët ekonomike.

## Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se me dt. 02.02.2017, rreth orës 09:00 minuta, në hyrje të Malishevës, pikërisht në rrugën. „Rilindja Kombëtare”, në afërsi të rrezikon trafikut publik duke shkëlur nenin 41 dhe nenin 231, lidhur me nenin 255 të Ligjit mbi rregullat e trafikut rrugor nr. 05/L-088 he vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që pa patentë, duke drejtuar automjetin e markës „VW-19E” me targa të regjistrimit ..., me ngjyrë të kaltër, me të arritur tek vendi kritik, ka filluar tejkalimin pa verifikuar komunikacionin në atë pjesë të rrugës dhe gjatë tejkalimit me pjesën e parë ballore godet, në pjesën e përparme ballore automjetin „VW-70XOA, metarga të regjistrimit ..., ngjyrë të kaltër, të cilin e drejtonte B. M., i cili ishte duke lëvizur nga drejtimi i kundërt, me ç`rast si rezultat i këtij aksidenti përpos dëmeve materiale në automjete, lëndime te lehta trupore pësojnë i dëmtuari B. M. dhe bashkudhëtarja e tij X. M. si dhe bashkudhëtarët e të pandehurit, H. B., H. B., dhe N. B., lëndime të konstatuara dhe përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të Dr. F. H., dhe Dr. V. K. të dt. 30.03.2017.

-me këtë ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4, 6, 7, 17, 41, 42, 49 par.1 pika 1.1, 51, 52 dhe 73 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të njëjtit i`a shqipton:

## DËNIMIN ME KUSHT

Ashtu që e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 (**katër**) muajve, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor pre 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Të dëmtuarit, H. B., N. B., H. B., X. M. dhe B. M., lidhur me kërkesën pasurore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt civil.

Obligohet i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia paguajnë shumën prej 20 euro ndërsa shpenzime të procedurës penale shumen prej 90.00 euro.

Të tëra këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të behet me detyrim.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore-Gjakovë me aktakuzën PP.nr. 153/17 të dt.18.04.2017, e ka akuzuar M. B., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar si dhe administrimit të gjitha provave, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt.26.06.2018, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës, prokurori i shtetit MoneSyla, i akuzuari M. B. si dhe i dëmtuari H. B., andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I akuzuari M. B., deklarohet i fajshëm, për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuzës, më vjen keq për rastin i cili ka ndodhur, natyrisht nuk e kam bërë me dashje, poratëditë kam pasur një rast urgjent pasi që e kam pasur nënën e sëmur e cia është e paralizuar, ku kam qenë duke e dërguar në shtëpinë e shëndetit temjeku dhe nuk e di as vet se si ka ardhur deri të aksidenti, ky ka qenë rasti im i parë që kam ra ndesh me ligjin, andaj kërkoj nga gjykata meqenëse jam i pa punë të merren parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit.

I dëmtuari H. B. deklaroi se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj të akuzuarit, dhe nuk parashtron kërkesë pasurore.

Prokurori i shtetit Mone Syla jep mendimin se pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe meqenëse i akuzuari e pranoi fajësinë, me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, dhe i akuzuari të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-në tersi u vërtetua se i akuzuari M. B. me dt. 02.02.2017, rreth orës 09:00 minuta, në hyrje të Malishevës, pikërisht në rrugën „Rilindja Kombëtare“, në afërsi të rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 41 dhe nenin 231, lidhur me nenin 255 të Ligjit mbi rregullat e trafikut rrugor nr. 05/L-088 he vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që pa patentë, duke drejtuar automjetin e markës „VW-19E“ me targa të regjistrimit ..., me ngjyrë të kaltër, me të arritur tek vendi kritik, ka filluar tejkalimin pa verifikuar komunikacionin në atë pjesë të rrugës dhe gjatë tejkalimit me pjesën e parë ballore godet, në pjesën e përparme ballore automjetin „VW-70XOA, metarga të regjistrimit ..., ngjyrë të kaltër, të cilin e drejtonte B. M., i cili ishte duke lëvizur nga drejtimi i kundërt, me ç'rast si rezultat i këtij aksidenti përpos dëmeve materiale në automjete, lëndime të lehta trupore pësuanë i dëmtuari B. M. dhe bashkudhëtarja e tij X. M. si dhe bashkudhëtarët e të pandehurit, H. B., H. B., dhe N. B., lëndime të konstatuara dhe përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të Dr. F. H., dhe Dr. V. K. të dt. 30.03.2017.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimit i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimit i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimit është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimit i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat me lart, ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke e vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPPK-së, të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale, të akuzuarit, pranimitin e fajësisë, pendimin e tij, është mbajtës i familjes, i gjendjes së dobët ekonomike, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, si dhe nuk është përsëritës i veprave penale, për herë të parë ndeshet me ligjin, kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me një dënim me kusht në kohëzgjatje prej 4 muajve burg, i cili dënim nuk do e ekzekutohet në afat prej 1 viti, nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 të KPPK-së, dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimin mbi udhëzimin në kontestin civil gjykata e mbështeti në nenin 463 par.1 dhe.2 të KPPK-së, ndërsa vendimin mbi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale gjykata e mbështeti në nenin 450 par.1 dhe 2 nënparag.2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

## **GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË**

**P.nr.143/17, me dt.26.062018.**

Sekretarja juridike  
Behije Karaçica

G j y q t a r i  
Lulzim Paçarizi

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

